



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

## **SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

**Njoftim për vënd pune të lirë në administratë në pozicionin “specialist-jurist, ne Sektorin e Prokurimeve Publike, në Prokurorinë e Përgjithshme.**

Prokuroria e Pergjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-b, pika 2 klasa B, për vëndin e punës në pozicionin “**specialist - jurist**”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet:

**Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Data e dorëzimit të dokumentave: 25.02.2018**

***\*Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

Konkurrimi për vëndin e punës në pozicionin “specialist- jurist” në Sektorin e Prokurimeve Publike, në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, do të bazohet në:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.97/2016, “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
- Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, “Për prokurimet publike”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.20147, “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”;
- Ligjin nr.8503, date 30.06.1999, “Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike ”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Rregulloren e Brendshme te Prokurorisë së Përgjithshme;
- Ne aftesite individuale, profesionale bazuar ne jeteshkrimin, qe konsiston ne nivelin e llojin e arsimimit, pervojës, trajnimeve lidhur me fushën, si dhe vleresimet e arritjeve vjetore;

b) Konkurrimi do te zhvillohet ne dy faza:

i. Faza e pare:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve per plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre te veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Sektori i Burimeve Njerëzore në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes se pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Kandidatet qe plotesojne kerkesat e pergjithshme dhe te vecanta te pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet në S.B.Nj dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit PP dhe në hyrjen kryesore te Prokurorisë së Përgjithshme.
- Kandidatet, qe nuk plotesojne kerkesat e percaktuara ne shpalljen per konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në S.B.Nj e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka te drejte te paraqese ankese prane S.B.Nj, brenda 5 (pesë) ditëve kalanderike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi mer përgjigje brënda 5 (pesë) ditëve kalanderike nga data e depozitimit të ankesës

ii. Faza e dyte perbehet nga vlerësimi i kandidatëve qe perfshin:

- Vleresimin e jeteshkrimit te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vleresimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me goje.

c) Pranimi do te behet per 1 (nje) vend pune në pozicionin “specialist- jurist”.

ç) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këti ligji.

d) Vendi i punes ne pozicionin pozicionin “**specialist - jurist**” ben pjese në grupin e administrimit te posaçem. Ai vepron nën autoritetin e Përgjegjës të Sektorit të Prokurimit Publik, ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore, por jo vetëm:

- specialisti i Prokurimit Publik kryen detyrat e caktuara në kuadrin e detyrave që ka sektori.

a) në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime është përgjegjës për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve të prokurimeve publike për Prokurorinë e Përgjithshme dhe të autoriteteve kontraktore të varësisë, brënda afateve kohore në sistemin elektronik të Agjensisë së Prokurimit Publik, Drejtorinë e Buxhetit dhe Thesarit në Ministrinë e Financave dhe një kopje në zyrat e thesarit në rrethe.

b) për fondet e krijuara apo të shtuara, si Prokuroria e Përgjithshme edhe autoritet kontraktore të varësisë hartojnë regjistra shtesë dhe i paraqesin pranë Specialistit të Prokurimit Publik, i cili, përgatit dhe pasqyron në sistemin elektronik të Agjensisë së Prokurimit Publik dhe një kopje në zyrat e thesarit në rrethe, për të reflektuar ndryshimet përkatëse.

ç) është përgjegjës për dorëzimin çdo katër muaj të regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike, për Prokurorinë e Përgjithshme dhe të autoriteteve kontraktore të varësisë, (sipas informacionit të hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit të dërguara prej tyre), brënda afateve kohore në Agjensinë e Prokurimit Publik dhe një kopje në zyrat e thesarit në rrethe.

c) është përgjegjës për dorëzimin e regjistrit vjetor të realizimeve të prokurimeve publike, për Prokurorinë e Përgjithshme dhe të autoriteteve kontraktore të varësisë, (sipas informacionit të hollësishëm për veprimtaritë e prokurimit të realizuara gjatë vitit paraardhës, të dërguara prej tyre), brënda afateve kohore në sistemin elektronik të Agjensisë së Prokurimit Publik, Drejtorinë e Buxhetit dhe Thesarit në Ministrinë e Financave dhe një kopje në zyrat e thesarit në rrethe.

**dh)** është përgjegjës që në bazë vlerës monetare të fondeve në dispozicion të përcaktojnë procedurën e prokurimit si dhe zhvillimin e këtyre procedurave, në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi si:

**dh.1.** përgatit dhe përpilon bashkë me anëtarët e tjerë të njësisë së prokurimit dokumentat e tenderit, kërkesat për kualifikim dhe kriteret e vlerësimit në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi dhe siguron nënshkrimin e tyre nga të gjithë anëtarët e komisionit të njësisë.

- kryen funksione të tjera të caktuara me ligj ose me urdhër të posaçëm.

dh) Kërkesat e veçanta të grupit të administrimit të posaçëm janë:

**Te këto përfunduar arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar në degën juridik me diplomë të nivelit Master profesional.**

**- Te këto përvojë pune, jo më pak se 10 vjet në administratë shtetërore, prioritet përben përvoja e punës së ngjashme me detyrat kryesore që do të kryejë në këtë pozicion pune.**

**- Te zotërojë me dëshmi metodat e reja të informacionit dhe të ketë aftësi shumë të mira të përdorimit të PC-së në programet baze të tij.**

**- Te ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.**

e) Lista e dokumentave që duhet të dorëzohen, sipas lidhjes nr.1, që i bashkelidhet njoftimit. Menyra e dorëzimit me postë ose drejtpërdrejtë në protokollin e institucionit me adresë: Prokuroria e Përgjithshme/Spektori i Burimeve Njerezore (konkurrimi për vendin e punës në pozicionin “specialist – jurist”) me adresë: Rruga “Qemal Stafa, nr.1, Tiranë.

ë) Afati i dorëzimit të dokumentave është data **23.02.2018**, i cili është jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në faqen elektronike dhe tek dera e Prokurorisë së Përgjithshme. Për dokumentat që dorëzohen me postë data e dorëzimit është ajo e vules postare në momentin e pranimit të objektit postar.

f) Data e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve është **28.02.2018**

g) Konkurrimi për vendin e punës në pozicionin “specialist- jurist ” do të zhvillohet:

- Vendi: Prokuroria e Përgjithshme, salla e mbledhjeve në adresën: Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tiranë.

gj) Menyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës dhe të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;

- Vlerësimi me shkrim;

- Intervista e strukturuar me gojë.

- Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100, te cilat ndahen perkatesisht:

÷ Per vleresimin e jeteshkrimit (cv) te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te eksperiencas e te trajnimeve, te lidhura me fushen, si dhe vleresimnet e arritjeve vjetore, 15 pike;

÷ Per intervisten e strukturuar me goje, 15 pike;

÷ Per vleresimin me shkrim, 70 pike.

i) Menyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet do te behet nepermjet adresave te e-mail-eve, me mesazhe ne numrin e celularit, ne faqen e internetit dhe tek dera e Prokurorisë së Përgjithshme.

Per me shume informacion per Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarine e saj mund te vizitoni edhe faqen tone ne internet: [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al)

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni me numrin telefonik (0694113193), ose ne adresen: Prokuroria e Përgjithshme, e Republikës së Shqipërisë, Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tirane.

## **PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**Tiranë më 25.02.2018**